



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 96, Datë 12.05.2025

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN PRILL 2025 PËR KLIENTËT
E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.06.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.05.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1664/1 prot., datë 09.05.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin prill 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

Konstatohet se:

I -Aspektet Ligjore dhe Procedurale

1. Paraqitja e kërkesës nga FSHU sh.a.

Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 2286 prot., datë 30.04.2025, protokolluar në ERE me nr. 1664 prot., datë 02.05.2025, ka depozituar kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin prill 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE

Kërkesa është shqyrtuar në përputhje me nenin 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe “Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar.

II – Analiza e përlllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i mundësisë së Fundit për muajin prill 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV

1. Blerja e energjisë në bursë

Për muajin prill 2025, FSHU sh.a. ka siguruar sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh përmes blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX), duke u bazuar në profilet ditore të prokuruar, çmimet ditore/orare dhe vlerat përkatëse të faturuara.

2. Përlllogaritja e Çmimit Mesatar të Ponderuar të Blerjes (ÇBEt)

Bazuar në të dhënat e paraqitura, FSHU sh.a. ka përlllogaritur çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për muajin prill 2025 në vlerën 7.82 lekë/kWh. Kjo vlerë është verifikuar edhe nga ERE, nëpërmjet një rillogaritjeje, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 7.82 lekë/kWh, në përputhje me përlllogaritjet e paraqitura nga shoqëria.

3. Komponentët sipas Metodologjisë (Neni 8, vendimi nr. 201, datë 04.12.2017, i ndryshuar)

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përlllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë si më poshtë:

- **Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt)** për muajin prill 2025: **7.82 lekë/kWh;**
- **Tarifa e shërbimit të transmetimit** të energjisë elektrike për periudhën 1 shkurt 2025 – 31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 279, datë 16.12.2024: **0.85 lekë/kWh;**
- **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes** në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të bordit të ERE nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE nr. 73, datë 13.04.2022”: **1.55 lekë/kWh;**
- **Kostot administrative: 1.06 lekë/kWh;**
- **Kurset zyrtare të këmbimit** të publikuara nga Banka e Shqipërisë (Lekë/Euro), për çdo datë respektive në harkun kohor **28.03.2025 -29.04.2025.**
- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të FSHU sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin prill 2025, përlllogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin prill 2025		
	Njësia	Çmimi
CBEt Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë	Lekë/kWh	7.82
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin	Lekë/kWh	0.23
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA	Lekë/kWh	11.51

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:
 - Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë *11.51 Lekë/kWh për muajin prill 2025*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin prill 2025 prej 11.51 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategoritë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga bordi i ERE-s.
3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI